



Procedurat ligjore dhe kërkesat për kompensim ndaj Administratës Tatimore të Kosovës dhe Doganës së Kosovës

Hyrje

E drejta e qytetarëve për të adresuar shkeljet e autoriteteve publike është një parim themelor i garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, përkatësisht Nenin 31: e drejta për mjete juridike¹. Ky parim siguron që çdo vendim gjyqësor apo administrativ që cenon të drejtat ose interesat e qytetarëve të mund të sfidohet përmes mekanizmave ligjorë.

Për të garantuar mbrojtjen më të lartë të të drejtave dhe lirive themelore, Kushtetuta ka përfshirë në sistemin juridik instrumente ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat kanë epërsi absolute ndaj ligjeve të tjera². Për më tepër, ajo përcakton që interpretimi i të drejtave dhe lirive themelore duhet të bëhet në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ), duke e detyruar kështu sistemin gjyqësor dhe institucionet publike të zbatojnë jurisprudencën e saj, përfshirë çështjet administrative³.

Për të mundësuar realizimin e këtyre të drejtave, Ligji për Gjykatat i vitit 2013 ka krijuar Departamentin për Çështje Administrative në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, me juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës⁴. Ky departament vepron si instanca e parë për trajtimin e rasteve administrative, ku qytetarët mund të paraqesin padi për shkeljet e pretenduara nga autoritetet publike dhe të kërkojnë kompensim për dëmet e shkaktuara. Nëse nuk janë të kënaqur me vendimet e marra nga kjo instancë, ata mund t'i drejtohen Gjykatës së Apelit

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 32, E Drejta për Mjete Juridike. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

2 Po aty. Neni 19, Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare, paragrafi 2.

3 Po aty. Neni 22, Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare.

4 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 06/L-054 për Gjykatat.Neni 13, Organizimi i Brendshëm i Gjykatës Themelore, paragrafi 1.3. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=18302>

si shkallë e dytë e shqyrtimit dhe, nëse e konsiderojnë të nevojshme, edhe Gjykatës Supreme e deri te Gjykata Kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave të tyre⁵.

Kjo procedurë gjyqësore është e rregulluar me Ligjin për Konfliktet Administrative (LKA), i cili siguron mbrojtjen gjyqësore të të drejtave dhe interesave të qytetarëve kundër veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve publike, duke vendosur mbi ligjshmërinë e tyre⁶. Njëkohësisht, kjo procedurë shërben si një mekanizëm për kontrollin e punës së organeve administrative, nga shqyrtimi i kërkesave të palëve deri te marrja e vendimeve përfundimtare, duke garantuar realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre nga një organ i pavarur gjyqësor.

Kjo e drejtë mund të ushtrohet vetëm pasi qytetarët të kenë shfrytëzuar paraprakisht të gjitha mjetet juridike të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Ky raport i shkurtër trajton dy raste të monitoruara në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore, ku të paditura janë Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe Dogana e Kosovës (Dogana). Këto raste pasqyrojnë sfidat ligjore dhe procedurale me të cilat përballen qytetarët në kërkimin e të drejtave të tyre dhe kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga organet publike⁷.

Raporti përfshin hyrjen, një përmbledhje të shkurtër të procedurës së ankesës administrative dhe asaj gjyqësore, ilustrimin e rasteve të monitoruara në gjykatë dhe përfundimet me rekomandimet kryesore.

Procedura e ankesës administrative

Me qëllim të mbrojtjes së të drejtave të tyre, qytetarët të cilët besojnë se janë dëmtuar nga një vendim apo veprim i një autoriteti publik dhe kërkojnë kompensim duhet të ndjekin një procedurë administrative fillimisht. Kjo procedurë fillon gjithmonë me paraqitjen e një kërkesë nga qytetari/ja tek organi përkatës administrativ dhe rregullohet me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA)⁸. Ky ligj siguron që vendimet që ndikojnë te të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve të jenë në përputhje me Kushtetutën, rregullat e përgjithshme ligjore dhe rregullat specifike të fushave përkatëse.

Gjatë zhvillimit të kësaj procedure, organet administrative janë të detyruara të nxjerrin vendime që përmbajnë të gjitha elementet e detyrueshme të përcaktuara me LPPA⁹. Vendimi duhet të përfshijë një arsyetim të qartë dhe të detajuar, i cili shpjegon bazën ligjore dhe faktike mbi të cilën është marrë vendimi¹⁰.

5 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Neni 113, Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara, paragrafi 7. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

6 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative. Neni 1, Qëllimi. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85181>

7 Sqarim: Ky është raporti i dhjetë i publikuar nga D+, i cili përfshin dy raste të monitoruara në gjykatë. Deri më tani, D+ ka monitoruar gjithsej 20 raste, të përmbledhura në 10 raporte të publikuara. Çdo raport ka përfshirë nga dy raste, duke ofruar shembuj konkretë që ndihmojnë qytetarët në ndjekjen e procedurave administrative dhe gjyqësore për realizimin e të drejtave të tyre.

8 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

9 Po aty. Neni 47, Struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar.

10 Po aty. Neni 48, Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim.

Në rast se qytetarët janë të pakënaqur me një vendim administrativ, ata duhet të paraqesin ankesë në organin e shkallës së dytë të autoritetit publik. Nëse organi administrativ i shkallës së dytë refuzon kërkesën e palës, atëherë pala ka të drejtë të paraqesë padi në gjykatë. Një padi e tillë mund të ushtrohet edhe pas vendimeve të organit të shkallës së parë, nëse në procedurën administrative nuk është e lejuar ankesa. Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative parashikon gjithashtu rastet kur autoriteti publik nuk vepron (hesht) dhe nuk i përgjigjet kërkesës së palës brenda afateve të përcaktuara me ligj. Në këto raste, vendimi konsiderohet automatikisht negativ, duke i krijuar qytetarit/es mundësinë për të ndërmarrë hapa të mëtejshëm ligjorë¹¹.

Procedura gjyqësore

Pasi të jenë shterur të gjitha mjetet juridike brenda procedurës administrative dhe të jenë marrë vendimet përfundimtare nga autoritetet publike, qytetarët kanë të drejtë të inicojnë një konflikt administrativ përmes padisë në gjykatë.

Padia synon shqyrtimin e ligjshmërisë së vendimeve administrative dhe garanton mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative. Ky ligj përcakton qartë procedurën për kontestimin e vendimeve të organeve shtetërore, duke ofruar një mekanizëm të strukturuar për realizimin efektiv të të drejtave të qytetarëve përmes mbrojtjes gjyqësore.

Padia duhet të dorëzohet në Gjykatën Themelore të Prishtinës – Departamenti për Çështje Administrative, duke respektuar afatet e përcaktuara me ligj. Gjatë këtij procesi, qytetari/ja ka të drejtë të kërkojë edhe kompensim për dëmin e shkaktuar. Sipas LKA, në rastet kur rikthimi në situatën e mëparshme nuk është i mundur apo është tejet jo proporcional, gjykata vendos kompensimin në të holla të dëmit dhe përcakton shumën e kompensimit¹².

Në këtë procedurë mund të kërkohet gjithashtu realizimi i kamatëvonesës prej 8%, bazuar në Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), i cili përcakton: “Detyrimi i shpërblimit të dëmit konsiderohet se ka arritur, për pagesë që nga momenti i shkaktimit të dëmit”¹³, si dhe “Lartësia e kamatëvonesës është 8% në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”¹⁴.

Këto procedura janë të rëndësishme për të garantuar një mekanizëm efektiv për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe kundërshtimin e vendimeve të padrejta të autoriteteve publike. Për një proces të suksesshëm, qytetarët/et duhet të veprojnë brenda afateve ligjore dhe të përgatisin dokumentacionin e nevojshëm, duke u bazuar në LPPA, LKA dhe legjislacionin përkatës për raste specifike.

¹¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Neni 125. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

¹² Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative. Neni 65, paragrafi 5. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85181>

¹³ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Neni 170. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2828>

¹⁴ Po aty. Neni 382, Kamatë vonesa.

Rastet në Gjykatën Themelore të Prishtinës – Departamenti për Çështje Administrative¹⁵

Në rastin e parë, paditësi R.S. ka kundërshtuar vendimin përfundimtar të Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), i cili vepron si organ i shkallës së dytë brenda këtij institucioni, duke iniciuar padi në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Sipas tij, ATK e kishte trajtuar gabimisht si person afarist dhe i kishte ngarkuar barrë tatimore mbi një shumë të caktuar, ndonëse ai ishte person fizik jo afarist dhe nuk ushtronte asnjë aktivitet biznesor. Paditësi pretendonte se vendimi përmbante shkelje të rënda procedurale dhe ligjore, prandaj kërkonte nga gjykata anulimin e tij dhe të obligonte ATK-në t'i kthente mjetet e paguara padrejtësisht.

Në rastin e dytë, paditësi G.D. ka kundërshtuar vendimin përfundimtar të Sektorit për Rishqyrtimin e Vendimeve të Doganës së Kosovës (Dogana), si organ i shkallës së dytë brenda këtij institucioni, dhe pas refuzimit të ankesës nga ky organ, pala ka iniciuar padi në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Dogana kishte vendosur një detyrim doganor të pajustificuar për një automjet të importuar, duke i shkaktuar dëm monetar paditësit. Për më tepër, vendimi i kontestuar përmbante shkelje të rënda procedurale dhe ligjore, prandaj paditësi kërkonte nga gjykata anulimin e tij dhe kthimin e mjeteve të paguara, përfshirë kamatën ligjore prej 8% nga dita e pagesës.

Rasti me ATK-në: Paditësi R.S. konteston cilësimin si subjekt afarist

Në këtë konflikt administrativ, paditësi R.S. ka sfiduar vendimin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), duke e cilësuar atë si të padrejtë dhe në kundërshtim me kornizën ligjore. ATK kishte vendosur një tatim mbi shumën prej 131,000 eurosh, duke e trajtuar paditësin si subjekt afarist, ndonëse ai është një person fizik jo afarist dhe nuk ushtron asnjë aktivitet biznesor.

R.S. paraqiti padi në gjykatë, më 22 qershor 2023, duke kërkuar anulimin e vendimit të ATK-së, të cilin ai e konsideron të kundërligjshëm. Seanca e parë gjyqësore u mbajt më 1 korrik 2024, ku paditësi argumentoi se, sipas ligjit, si person fizik jo afarist, nuk është i detyruar të paguajë tatim mbi fitimet kapitale. Ai theksoi se vendimi i ATK-së përmbante shkelje të shumta procedurale dhe ligjore.

Gjithashtu, paditësi vuri në dukje shkeljen e Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale,¹⁶ i cili saktëson se një person fizik jo afarist, që nuk ka aktivitet të regjistruar biznesor, nuk mund të ngarkohet me tatim mbi fitimet kapitale në mungesë të një akti nënligjor të nxjerrë nga ministri, i cili do të përcaktonte mënyrën e trajtimit të këtyre fitimeve ose humbjeve¹⁷.

R.S. theksoi se raporti i kontrollit i vetë ATK-së konfirmonte se ai ishte regjistruar si person fizik pa asnjë aktivitet biznesor apo ndonjë aktivitet tjetër ekonomik personal. Për më tepër, gjatë procesit të kontrollit, paditësit i ishte lëshuar numri fiskal për vitin 2021. Megjithatë, ATK kishte vendosur tatim mbi një qarkullim të pretenduar prej 772,841.37 euro, duke e trajtuar këtë shumë si fitim kapital dhe duke e klasifikuar padrejtësisht paditësin si subjekt afarist.

¹⁵ Sqarim: Rastet e monitoruara në gjykatë trajtohen sipas dispozitave të Ligjit të vjetër për Konflike Administrative, pasi ligji i ri ka hyrë në fuqi në janar të këtij viti, ndërkohë që monitorimi i këtyre rasteve është bërë para kësaj kohe.

¹⁶ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11014>

¹⁷ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 05/L-028 për Tatimin në të Ardhurat Personale. Neni 31, Fitimet dhe humbjet kapitale. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11014>

Nga ana tjetër, përfaqësuesi i të paditurës, ATK-së, kundërshtoi padinë dhe kërkesëpadinë, duke propozuar që gjykata ta refuzojë atë si të pabazuar. Ai argumentoi se paditësi nuk kishte respektuar legjislacionin tatimor dhe nuk kishte ofruar prova për të vërtetuar të kundërtën.

Gjykata, pas shqyrtimit të provave dhe analizës së legjislacionit në fuqi, konstatoi se vendimi i ATK-së nuk kishte bazë ligjore dhe shkelte nenet 47 dhe 48 të LPPA-së, pasi mungonin struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, përfshirë arsyetimin mbi bazën ligjore dhe faktet që çuan në marrjen e atij vendimi. Gjykata evidentoi mungesën e një akti nënligjor të detyrueshëm për trajtimin e fitimeve kapitale për individët jo afaristë.

Në aktgjykimin e saj, gjykata ju referua Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, i cili përcakton se: “Mënyra e trajtimit të fitimeve/humbjeve kapitale për individët (persona fizikë jo afaristë) do të përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga ministri”¹⁸. Duke qenë se akti nënligjor nuk ishte nxjerrë, gjykata vlerësoi se paditësi ishte ngarkuar padrejtësisht me barrë tatimore. Gjithashtu, gjykata konstatoi se ATK kishte aplikuar gabimisht të drejtën materiale, duke e trajtuar R.S. si person fizik afarist, ndonëse ai nuk ishte regjistruar asnjëherë në Agjencinë e Kosovës për Regjistrimin e Bizneseve, e cila funksionon në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë.

Si përfundim, bazuar në këto konstatime, Gjykata Themelore vendosi të anulojë vendimin e ATK-së dhe të obligojë atë që t’i kthejë paditësit R.S. shumën prej 73,336 euro, të cilën ai e kishte paguar deri më tani. Çështja është apeluar nga ATK dhe ende nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit¹⁹.

Rasti me Doganën e Kosovës: Paditësi G.D. kundër shkeljes së procedurës për doganimin e automjetit

Kjo çështje administrative lidhet me vlerësimin e çmimit të transaksionit për një automjet të importuar, ku paditësi, G.D., pretendon se Dogana e Kosovës ka shkelur rregullat e procedurës administrative dhe ka zbatuar gabimisht dispozitat e së drejtës materiale. Sipas tij, si rezultat i këtyre shkeljeve, ai është detyruar të paguajë një shumë shtesë prej 3,040.85 euro në emër të detyrimeve doganore.

Fillimisht, paditësi ushtroi ankesë në Sektorin për Rishqyrtimin e Vendimeve të Doganës së Kosovës, por kjo ankesë u refuzua. Për pasojë, paditësi nisi një proces gjyqësor më 3 gusht 2022, duke kërkuar anulimin e vendimit të Doganës, i cili refuzonte njohjen e vlerës së deklaruar për doganimin e automjetit. Ai pretendoi se kishte dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme, përfshirë faturat dhe detajet e pagesës përmes bankës, të cilat sipas tij ishin të mjaftueshme për të provuar çmimin e transaksionit.

Gjatë seancës kryesore më 3 korrik 2024, përfaqësuesi ligjor i paditësit argumentoi se Dogana kishte shkelur nenin 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë (KDAK), i cili përcakton se: “Vlera doganore e mallrave të importuara është vlera e transaksionit, që paraqet çmimin vërtet të paguar ose të pagueshëm për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, i përshtatur, sipas nevojës, në përputhje me nenet 36 dhe 37”²⁰. Ai theksoi gjithashtu se Dogana kishte shkelur nenin 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009, që përcakton dokumentet që duhet t’i bashkëngjiten deklaratës doganore²¹.

¹⁸ Po aty. Neni 31, Fitimet dhe humbjet kapitale, paragrafi 12.

¹⁹ Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr. 2017/2023. Datë: 01.07.2024.

²⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Kodi Nr. 08/L-247 Doganor dhe të Akcizave. Neni 33, Ruajtja e dokumenteve dhe e informacioneve të tjera. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=89203>

²¹ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Udhëzimi Administrativ Nr. 11/2009 për Implementimin e Kodit të Doganave dhe Akcizës.

Sipas përfaqësuesit ligjor, paditësi kishte dorëzuar dokumente të mjaftueshme, përfshirë faturat dhe provat e pagesave, të cilat duhet të përdoren si bazë për llogaritjen e detyrimeve doganore. Refuzimi i Doganës, bazuar në mungesën e kontratës së shitblerjes, u konsiderua i pabazuar, pasi një dokument i tillë nuk kërkohet nga dispozitat e KDAK-së. Për më tepër, Dogana kishte vlerësuar çmimin e automjetit duke u mbështetur në oferta nga burime online, të cilat nuk reflektonin çmimin real të transaksionit dhe nuk merrnin parasysh amortizimin dhe kilometrat e përshkuara nga automjeti.

Në anën tjetër, përfaqësuesja ligjore e Doganës mbrojt vendimin, duke argumentuar se aktvendimi ishte në përputhje me ligjin, pasi vlera e deklaruar nga paditësi ishte më e ulët se ajo e vlerësuar si reale. Sipas këtij aktvendimi, rivlerësimi i automjetit është bërë në bazë të dhënave të disponueshme që posedon Dogana e Kosovës, përkatësisht katalogu sipas shënimit të brendshëm të Doganës. Për më tepër, Dogana kishte përdorur një aplikacion online për të përcaktuar vlerën mesatare të automjetit, duke kombinuar vlera nga tri burime të ndryshme dhe duke e konsideruar dokumentacionin e dorëzuar të pamjaftueshëm.

Pas shqyrtimit të rastit, Gjykata Themelore konstatoi se vendimi i Doganës nuk përmbante arsyetim të mjaftueshëm dhe kishte shkelur parimet e procedurës administrative. Gjykata vlerësoi se vendimi ishte i paqartë, kontradiktor dhe nuk trajtonte faktet vendimtare apo pretendimet e paraqitura nga paditësi, duke shkelur nenin 48 të LPPA. Sipas këtij neni, “një arsyetim i dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërtshëm apo i pakuptueshëm është i barabartë me mungesën e tij”²².

Gjykata gjithashtu iu referua nenit 134 të LPPA-së, i cili specifikon: “Krahas kërkesave të nenit 48 të këtij Ligji, arsyetimi i aktit administrativ që zgjidh ankesën, do të përmbajë, gjithashtu, vlerësimet e të gjitha pretendimeve të parashtruara nga pala në ankesë”²³. Për më tepër, gjykata konstatoi se metoda e përdorur për vlerësimin doganor nuk ishte në përputhje me nenin 33 të KDAK-së, i cili përcakton se vlera doganore duhet të bazohet në çmimin e transaksionit, përfshirë pagesat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta si kusht i shitjes.

Lidhur me këtë rast, Gjykata Themelore urdhëroi që çështja të rikthehej për rishqyrtim dhe rivedosje në Doganën e Kosovës. Ajo udhëzoi Doganën të shqyrtojë të gjitha provat dhe pretendimet e paditësit, përfshirë gjendjen faktike të automjetit, vjetërsinë dhe kilometrat e tij, si dhe të sigurojë një arsyetim të qartë dhe të mbështetur në prova për vendimin e ardhshëm²⁴.

Megjithatë, më 30.09.2024, Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve në Doganën e Kosovës e refuzoi sërish ankesën e paditësit²⁵. Për këtë arsye, paditësi paraqiti ankesë pranë Bordit të Ankesave për Rishqyrtimin e Vendimeve të Doganës dhe ATK-së, organ brenda Ministrisë së Financave. Megjithatë, Bordi nuk dha përgjigje brenda afatit ligjor. Për shkak të heshtjes administrative, paditësi ngriti padi në Gjykatën Themelore për herë të dytë, duke kërkuar anulimin e vendimit të Doganës si të kundërligjshëm dhe kthimin e shumës së paguar më tepër për detyrime doganore. Rasti është në pritje të shqyrtimit nga kjo gjykatë²⁶.

Neni 123, Dokumentet që duhet bashkangjitur deklaratës doganore. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=7746>

22 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Neni 48, Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

23 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Neni 134, Përmbajtja dhe pasojat e aktit që zgjidh ankesën. I qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12559>

24 Vendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.nr. 1909/2022. Datë: 03.07.2024.

25 Komunikim elektronik me Zyrën për Komunikim dhe Qasje në Dokumente Zyrtare të Doganës së Kosovës. Datë: 11.02.2025.

26 Komunikim elektronik me përfaqësuesin ligjor të paditësit, K.B. Datë: 24.02.2025.

PËRFUNDIME

Monitorimi i këtyre dy rasteve është bërë në Gjykatën Themelore të Prishtinës – Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa statusi i këtyre rasteve është ndjekur gjithashtu në shkallën e dytë, në Gjykatën e Apelit. Përvoja nga këto raste konfirmon problematika të ngjashme me ato të hasura në monitorimet e mëparshme, duke vënë në pah sfida të përsëritura që ndikojnë në efektivitetin dhe drejtësinë e procedurave administrative gjyqësore.

Qytetarët përballen me procese gjyqësore të tejzgjatura, ku mesatarisht, një vendim në shkallën e parë të gjykatës kërkon mbi dy vjet²⁷ për t'u marrë, dhe kur çështja apelon në shkallët e tjera, ky proces mund të zgjatet edhe më tej, duke e bërë këtë procedurë edhe më të gjatë.

Vonesat në trajtimin e rasteve nuk prekin vetëm qytetarët, por rëndojnë edhe mbi gjykatat, të cilat përballen me ngarkesë të madhe pune. Aktualisht, vetëm dhjetë gjyqtarë janë të caktuar për trajtimin e çështjeve administrative në Gjykatën Themelore në Prishtinë, çka tregon se kapacitetet institucionale janë të kufizuara²⁸. Vetëm në vitin 2024 ka një numër të konsiderueshëm lëndësh administrative me 9910 raste, megjithatë mungojnë statistikat për rastet që lidhen vetëm me kompensimin e dëmit, pasi kjo e drejtë nuk monitorohet nga institucionet e vendit²⁹.

Në rastet kur qytetarët fitojnë paditë e tyre, ata kanë të drejtë të kompensohen për dëmin e shkaktuar, përfshirë kamatën ligjore prej 8% të përcaktuar me ligj, gjë që përbën një barrë shtesë për buxhetin e shtetit. Për këtë arsye, respektimi dhe zbatimi i plotë i legjislacionit në fuqi mbetet thelbësor për të shmangur dëmet e panevojshme ndaj qytetarëve dhe shpenzimet e paarsyeshme të financave publike.

Në dy rastet e monitoruara, paditë e iniciuara në 2021 dhe 2022 ende nuk kanë marrë epilog, pavarësisht se janë trajtuar në shkallën e parë. Në rastin e parë, gjykata kishte marrë një vendim meritore në favor të palës paditëse, por çështja u apelua nga e paditura (ATK), duke e zgjatur më tej procesin. Në rastin e dytë, gjykata e shkallës së parë e ktheu çështjen për rishqyrtim dhe rivendosje tek Dogana e Kosovës, e cila refuzoi sërish kërkesën e paditësit. Ndërkohë, Bordi i Ankesave nuk ka dhënë përgjigje brenda afatit ligjor, duke e detyruar palën t'i drejtohet përsëri Gjykatës Themelore. Rasti mbetet ende në pritje të shqyrtimit nga gjykata e shkallës së parë dhe nuk ka një vendim përfundimtar.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Konflike Administrative në janar 2025, pritet të forcohet mbrojtja e të drejtave të qytetarëve dhe të përmirësohet efikasiteti i gjykimeve administrative. Ky ligj do të detyrojë gjykatat të marrin vendime meritore, duke shmangur praktikën e deritanishme të kthimit të çështjeve për rishqyrtim dhe rivendosje tek autoritetet publike. Kjo reformë synon të përshpejtojë zgjidhjen e rasteve dhe të parandalojë vonesat e panevojshme që rëndojnë qytetarët dhe buxhetin e shtetit.

Vendimet e autoriteteve publike, ATK dhe Dogana, kanë qenë jo profesionale dhe jo ligjore, pasi nuk kanë përmbytur elementet e detyrueshme të një akti administrativ të shkruar, përfshirë arsyetimin mbi bazën ligjore dhe faktet përkatëse. Këto vendime kanë shkelur dispozitat e LPPA-së, specifikisht nenet 47 dhe 48 në rastin e parë me ATK-në, dhe të njëjtat nene, si dhe nenin 134, në rastin e dytë me Doganën e Kosovës. Gjithashtu, gjykata ka evidentuar shkeljen e Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale në rastin e parë, dhe të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë në rastin e dytë.

27 OECD (2024). "Administrata publike në Kosovë* 2024: Vlerësimi sipas Parimeve të Administratës Publike" Raporti i Monitorimit SIGMA. I qasshëm në: https://www.oecd.org/en/publications/public-administration-in-kosovo-2024_a53fce6b-en.html

28 Komunikim elektronik me Zyrën për Informim dhe Komunikim me Media të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Datë: 06.02.2025.

29 Komunikim elektronik me Zyrën për Informim dhe Komunikim me Media të Gjykatës Themelore në Prishtinë. Datë: 06.02.2025.

REKOMANDIME

Duke u bazuar në rastet e trajtuara, D+ rekomandon:

- Autoritetet publike, në këtë rast ATK dhe Dogana, të sigurojnë që vendimet e tyre të jenë të arsyetuara qartë dhe të mbështetura në ligj, duke zbatuar saktësisht nenet 47 dhe 48 të LPPA.
- Vendimet e organit të shkallës së dytë pranë këtyre autoriteteve publike, gjatë rishqyrtimit administrativ, duhet të jenë objektive dhe të paanshme, në mënyrë që të shmangen paditë në gjykatë, të cilat ngarkojnë sistemin gjyqësor, por edhe shtetin me kosto financiare të panevojshme.
- Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Konflike Administrative, institucionet shtetërore, përmes IKAP dhe/ apo donatorëve të jashtëm, duhet të organizojnë trajnime për gjyqtarët, avokatët, profesionistët ligjorë, me qëllim të sigurimit të një zbatimi efikas dhe të unifikuar të këtij ligji.
- Për të menaxhuar ngarkesën e lartë të lëndëve dhe për të siguruar trajtim të shpejtë dhe të drejtë të rasteve, është e nevojshme që Këshilli Gjyqësor i Kosovës të angazhohet në rritjen e numrit të gjyqtarëve dhe stafit mbështetës në Departamentin për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore në Prishtinë.